



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

RREGULLORE (P) NR. 05/2016
PËR PUNËN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DEKORATA

Prishtinë, 21.12.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

Presidenti i Republikës së Kosovës,
Në mbështetje të nenit 84 (pika 28) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-094, për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 47, 25 janar 2009), si dhe neneve 9 (6) dhe 18 të Ligjit nr. 04/L-070 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 02, 20 janar 2012), nxjerr:

RREGULLORE (P) NR. 05/2016
PËR PUNËN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DEKORATA

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i punës së Komisionit Vlerësues për Dekorata.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e përcaktuara me këtë rregullore vlejnë për anëtarët e Komisionit Vlerësues për Dekorata dhe njësitë përkatëse të Presidencës.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **President** - nënkupton Presidentin e Republikës së Kosovës;
 - 1.2. **Komision** - nënkupton Komisionin Vlerësues për Dekorata;
 - 1.3. **Dekoratë** - nënkupton urdhrat, medaljet, çmimet, mirënjohjet dhe titujt e nderit që i jep Presidenti;
 - 1.4. **Revokim i dekoratës** - heqja e së drejtës dikujt për bartjen e dekoratës së dhënë nga Presidenti;

- 1.5. **Person** - nëse konteksti nuk nënkupton ndryshe, përfshin personat fizikë dhe personat juridikë;
 - 1.6. **Departamenti për Çështje Juridike (DÇJ)** - nënkupton Departamentin për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Presidentit;
 - 1.7. **Zyrtari përkatës për dekorata** - nënkupton zyrtarin në kuadër të Departamentit për Çështje Juridike;
 - 1.8. **Anëtar i Komisionit** - kur nuk përdoret ndryshe, nënkupton kryetarin dhe anëtarin e Komisionit;
 - 1.9. **Ligj** - nënkupton Ligjin nr. 04/L-070 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 02, 20 janar 2012).
2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë si në përkufizimet e Ligjit.

II. KOMISIONI VLERËSUES PËR DEKORATA

Neni 4

Emërimi i Komisionit

1. Komisioni emërohet nga Presidenti.
2. Presidenti nxjerr vendim për emërimin, shkarkimin apo ndërprerjen e mandatit të anëtarëve të Komisionit.

Neni 5

Përbërja e Komisionit

1. Komisioni përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve.
2. Së paku njëri anëtar duhet të jetë nga Zyra e Presidentit dhe do të jetë kryetar i Komisionit.
3. Së paku njëri anëtar duhet të jetë nga radhët e komuniteteve joshumicë në Kosovë, i cili propozohet nga Këshilli Konsultativ për Komunitete.

Neni 6

Mandati i Komisionit

Komisioni emërohet me mandat 2 (dy) vjeçar, me mundësi riemërimi.

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka detyrat dhe përgjegjësitë si në vijim:
 - 1.1. Analizon propozimin për dekoratë që i drejtohet Presidentit, nga subjektet që janë të përcaktuara në ligj;

- 1.2. I propozon Presidentit dhe e arsyeton propozimin për dhënien, mosdhënien apo revokimin e dekoratës;
- 1.3. Mund t'i propozojë Presidentit dhënien e dekoratës dhe e arsyeton propozimin.

Neni 8 **Kryetari i Komisionit**

1. Kryetari i Komisionit ka këto kompetenca:
 - 1.1. Organizon dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës së përgjithshme të Komisionit;
 - 1.2. Thërret dhe kryeson takimet e Komisionit;
 - 1.3. Siguron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe legjislacionit përkatës në fuqi;
 - 1.4. Përfaqëson Komisionin në kontakt me publikun apo autorizon njërin nga anëtarët për këtë përfaqësim;
 - 1.5. Përcakton punët dhe detyrat për anëtarët e Komisionit.
2. Kryetari i Komisionit i përgjigjet drejtpërdrejt Presidentit për punën e Komisionit.

Neni 9 **Obligimet e anëtarëve të Komisionit**

1. Anëtarët e Komisionit janë të obliguar për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi në përputhje me mandatin e Komisionit.
2. Anëtarët e Komisionit janë të obliguar të marrin pjesë në takimet e Komisionit dhe në shqyrtimin e propozimeve në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 10 **Dorëheqja**

1. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit mund të japin dorëheqje nga Komisioni.
2. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit duhet ta njoftojnë Presidentin për dorëheqjen e tyre.
3. Anëtari që jep dorëheqjen duhet të kryejë të gjitha detyrat deri në caktimin e anëtarit të ri nga Presidenti.

Neni 11 **Shkarkimi apo ndërprerja e mandatit**

1. Presidenti me vendim mund ta shkarkojë apo t'ia ndërpresë mandatin anëtarit të Komisionit nëse:
 - 1.1. Nuk i kryen detyrat që i janë dhënë;
 - 1.2. Keqpërdor dhe/apo neglizhon pozitën e tij si anëtar i Komisionit;
 - 1.3. Nuk merr pjesë pa arsye 3 (tri) herë radhazi në mbledhjet e Komisionit;
 - 1.4. Vlerëson se një gjë e tillë është e nevojshme.
2. Në rastet e shkarkimit apo ndërprerjes së mandatit të anëtarëve të Komisionit, Presidenti e emëron anëtarin e ri.

Neni 12
Pavarësia e punës së Komisionit

1. Anëtarët e Komisionit janë të pavarur në punën e tyre dhe kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me legjislacionin në fuqi.
2. Asnjë person nuk mund të ushtrojë ose të tentojë të ushtrojë ndikim në Komision.

III. PUNA E KOMISIONIT

Neni 13
Procedurat e punës së Komisionit

1. Procedurat e punës së Komisionit zhvillohen si në vijim:
 - 1.1. Nëse propozimi për dekoratë është i plotë, Departamentit për Çështje Juridike bën paraqitjen e tij te Komisioni;
 - 1.2. Kryetari i Komisionit e autorizon zyrtarin përkatës për dekorata që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për mbajtjen e takimit të Komisionit;
 - 1.3. Komisioni mblidhet në takim dhe shqyrton propozimet përkatëse;
 - 1.4. Kuorumi për mbajtjen e takimit është 2/3 e anëtarëve;
 - 1.5. Komisioni, pasi analizon propozimet, i rekomandon me shkrim Presidentit për dhënien apo mosdhënien e dekoratës, si dhe formulon motivacionin për dhënien e dekoratës;
 - 1.6. Komisioni i ndjek të njëjtat procedura edhe në rastet kur i propozon Presidentit revokimin e dekoratës.
2. Miratimi i propozimeve për dekorata është e drejtë e Presidentit.
3. Presidenti vlerëson propozimin, e miraton ose nuk e miraton, vendos për të dhënë dekoratë tjetër nga ajo që i është propozuar ose e riformulon motivacionin.
4. Në rast kur rekomandimi miratohet nga Presidenti, Departamenti për Çështje Juridike përgatit vendimin, certifikatën dhe siguron medaljen përkatëse.

Neni 14
Marrja e vendimeve

1. Vendimet në Komision merren me konsensus, në rast të mungesës së konsensusit në mes të anëtarëve të Komisionit vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të Komisionit.
2. Në rekomandimin e dërguar Presidentit duhet të ceken votat për dhe kundër.

Neni 15
Procesverbali i takimit

1. Për çdo takim të Komisionit mbahet procesverbal.
2. Procesverbali mbahet nga zyrtari përkatës për dekorata.

3. Në procesverbal përfshihen një përmbledhje e diskutimit, data dhe vendi i takimit, anëtarët që marrin pjesë, çështjet e diskutuara dhe vendimet që merren.
4. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Neni 16
Mbështetja e punës së Komisionit

1. Zyrtari përkatës për dekorata e mbështet punën e Komisionit, duke i ofruar ndihmë teknike dhe logjistike.
2. Pas përfundimit të punës së Komisionit, i gjithë dokumentacioni administrohet nga zyrtari përkatës për dekorata dhe arkivohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 17
Bashkëpunimi me Komisionin

Të gjitha njësitë e Presidencës obligohen të bashkëpunojnë me Komisionin dhe me zyrtarin përkatës për dekorata, me qëllim të ofrimit të ndihmës së kërkuar.

Neni 18
Kompensimi i Komisionit

Kompensimi i anëtarëve të Komisionit përcaktohet me vendim të sekretarit të Zyrës së Presidentit.

Neni 19
Buxheti

Sekretari i Zyrës së Presidentit siguron buxhetin e nevojshëm për punën, angazhimin, pjesëmarrjen në takime, si dhe funksionimin e përgjithshëm të Komisionit.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 20
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI,
President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, 21.12.2016